



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-077

Prishtinë, më 17 nëntor 2016, në orën 20:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Sali Morina dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
3. Të ndryshme.

* * *

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të mërkurën, më 30 nëntor 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje kërkohen të paktën 80 vota “për”),*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës penale, (Komisioni Funkcional për Legjislacion ka propozuar me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit që shqyrtimi i parë dhe i dytë të bëhet në të njëjtën ditë, në dy seanca plenare),*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, (për miratimin e këtij Projektligji kërkohen të paktën 61 vota „për“, prej tyre 11 vota „për“ të komuniteteve që nuk janë shumicë) Amendamenti 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 81, paragrafi 1),*
10. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë,*
11. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa,*
12. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim,*
13. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rrethit të tij,*
14. *Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015,*
15. *Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015,*
16. *Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015,*

17. *Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017,*

18. *Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, të kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit, të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a.,*

19. *Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit për Trashëgimi Kulturor,*

20. *Zgjedhja e 2 (dy) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. *Nisma legislative e Projektligjit për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, e hartuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me nismën legislative të lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji, në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

2. *Nisma legislative e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158, hartuar nga deputeti Shaip Muja, i mbështetur edhe nga 5 deputetë të tjerë*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me nismën legislative të lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158, si dhe të përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji, në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

3. *Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017-2019 në bazë të Qarkores së dytë buxhetore të Ministrisë së Financave 2017/02*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017-2019.

2. Kërkohet nga Ministria e Financave që të njëjtat kërkesa t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017-2019.

4. Kërkesa e deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë për debat parlamentar lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryesia, pas diskutimit lidhur me kërkesën e deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë për debat parlamentar lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, konstatoi se kjo kërkesë do të radhitet në rend të ditës në seancën tjetër të radhës, në përputhshmëri me Rregulloren e Kuvendit.

5. Kërkesa e kryetarit të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, z. Xhavit Haliti, për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të këtij komisioni dhe stafit mbështetës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që anëtarëve të komisionit dhe stafit mbështetës nga Administrata e Kuvendit t'u paguhen mëditjet në bazë të Rregullores në fuqi.

6. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bosnjë e Hercegovinë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Elmi Reçica, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Puhie Demaku dhe Pal Lekaj u lejohet udhëtimi zyrtar në Bosnjë e Hercegovinë nga data 24-27 nëntor 2016.

2. Shpenzimet e transportit, akomodimit, qëndrimit si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. Kërkesa e deputetes Shukrije Bytyqi për lejimin e udhëtimit në Kroaci

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e deputetes Shukrije Bytyqi për lejimin e udhëtimit në Kroaci, konstatoi se duhet të shikohet ftesa dhe programi i vizitës dhe të vendosë në mbledhjen e radhës.

8. Kërkesa e deputetit Bardhyl Meta për mbështetje financiare për shërim, shuma e kërkuar 9 740 euro (vetëm për konfirmim)

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, e konfirmoi këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa e deputetit të Kuvendit të Kosovës, z. Bardhyl Meta për mbështetje financiare në shumën prej 9 740 euro për shërim jashtë vendit.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

9. Kërkesa e nëpunësit të Administratës së Kuvendit, Ismet Mahmuti, për mbështetje financiare për shërim, shuma sipas faturave është 2 705.00 euro

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa e zyrtarit të Administratës të Kuvendit të Kosovës, z. Ismet Mahmuti, për mbështetje financiare për shërim në shumën prej 2 705 eurosh.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

10. Kërkesa e Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës për mbështetje financiare, shuma 2 000 litra naftë për ngrohje

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës për mbështetje në shumën prej 2 000 (dy mijë) euro për furnizim me naftë për ngrohje.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

11. Kërkesa e Shoqatës “Miqte e Amerikës” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës “Miqte e Amerikës” për mbështetje financiare, në shumën prej 1 897 eurosh.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

12. Mbulimi i shpenzimeve në shumën prej 8 486,00 €, me rastin e shënimit të 25-vjetorit të shpalljes së Kushtetutës së Kosovës, nën përkujdesjen e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e shënimit të 25-vjetorit të shpalljes së Kushtetutës së Kosovës në shumën prej 8 486 eurosh.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

13. Njoftimi i 2 (dy) nënkryetarëve të Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në punimet e sesionit të katërt të rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Kryesia u njoftua me raportin e dy (2) nënkryetarëve të Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe znj. Aida Dërguti, lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në punimet e sesionit të katërt të rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të mbajtura në Strasburg, Francë, nga data 10 - 14 tetor 2016.

14. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri nga data 14 - 16 tetor 2016.

15. Njoftimi i Komisionit për Integritet Evropian lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Çeki

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Integritet Evropian lidhur me vizitat zyrtare të realizuar në Çeki, nga data 24 - 26 tetor 2016.

16. Njoftim lidhur me procesin e anëtarësimit në Organizatën Globale të Parlamentarëve Kundër Korrupsionit (GOPAC)

Kryesia u njoftua me shkrim nga deputetja Valdete Bajrami për formimin e Grupit punues nga Komisioni për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, më 13 shtator 2016, i cili Grup punues në kuadër të aktiviteteve të tyre do t'i ndërmarrë veprimet për anëtarësim në Organizatën Globale të Parlamentarëve Kundër Korrupsionit (GOPAC), aktivitete të cilat gjithashtu janë duke u mbështetur nga UNDP-ja.

17. Njoftimi i kryetarit të Grupit të Miqësisë Kosovë-Slloveni, z. Elmi Reçica, lidhur me vizitën zyrtare të këtij grupi të realizuar në Lubjanë, Slloveni, prej 10 deri më 13 tetor 2016

Kryesia u njoftua me raportin e kryetarit të Grupit të Miqësisë Kosovë-Slloveni, z. Elmi Reçica, lidhur me vizitën zyrtare të këtij grupi të realizuar në Lubjanë, Slloveni, nga data 10 - 13 tetor 2016.

18. Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-396, datë 5 shtator 2013.

3. Të ndryshme

1. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve për shënimin e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit Kombëtar

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa për shënimin e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit Kombëtar, te varri i heroit të kombit, Isa Boletini, nën organizimin e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Shuma e mjeteve financiare deri në 12 000 (dymbëdhjetë mijë) euro ndahen nga kategoria ekonomike: Mallra dhe shërbime.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 21:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*